



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.07.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 10:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.

3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).

4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).

5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator – z. Ilir Toska).

Naureda Llagami: Atëherë, meqë të gjithë jemi prezent, po fillojmë mbledhjen e radhës të datës 20 korrik 2020. Është një mbledhje e cila është thirrur për shkak të fillimit, pa vonesë të procedurave të verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është përpiluar një projekt-akt. Për më shumë detaje, dëshiroj t’ia jap fjalën kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021”.

Sipas nenit 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, përveç funksioneve të parashikuar shprehimisht në këtë dispozitë, ushtron edhe çdo funksion tjetër të caktuar me ligj.

Ndërkohë, në pikën 1, të nenit 85, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor

bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë në pajtim me këtë ligj dhe ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ...”. Pra, sipas kësaj dispozite ligjore, Këshillit i është caktuar dhe një funksion tjetër, ai për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, funksion ky i përbashkët me Shkollën e Magjistraturës.

Në nenin 86, të këtij ligji, ku përcaktohen përgjegjësitë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në shkronjën “ë”, të kësaj dispozite, parashikohet përgjegjësia e Këshillit në lidhje me çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore.

Përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket rekrutimit të kandidatëve për gjyqtarë, gjen rregullim në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikërisht në nenin 32, në të cilin përcaktohet detyrimi i Këshillit për verifikimin e kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve në kuadër të zhvillimit të karrierës gjyqësore, përfshirë edhe të atyre për në formimin fillestar për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. Sipas këtij akti nënligjor, konkretisht Kreut V, Seksioni A, pika 1, shkronja “a”, procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit, ndër të tjera, “jo më vonë se 7 ditë nga publikimi i listës përfundimtare të kandidatëve për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës”.

Pikërisht, në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, në kushtet kur Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. 492 prot., datë 17.07.2020, protokolluar në

Këshill me aktin nr. 3383 prot., datë 17.07.2020, ka përcjellë listën e kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021.

Në vijim, sipas Kreut V, Seksioni A, pika 2, të aktit nënligjor si më lart: “Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit për secilin kandidat”. Në zbatim të këtij rregulli, Këshilli, në të njëjtën ditë të mbledhjes kur duhet të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, do të duhet të caktojë dhe relatorin për secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Referuar listës së kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021, rezulton të jenë 40 kandidatë, pra në përputhje me numrin e përcaktuar nga Këshilli me Vendimin nr.31, datë 23.01.2020.

Në nenin 31, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “1. Shkolla e Magjistraturës organizon provimin për pranimin në formimin fillestar në përputhje me rregullat që parashikon ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”. Provimi i pranimit zhvillohet në fund të muajit prill të çdo viti dhe është i hapur për të gjithë kandidatët e përfshirë në listën e kandidatëve, siç përcaktohet në procedurat e vlerësimit, të parashikuara në nenin 30 të këtij ligji. 2. Shkolla e Magjistraturës harton listën e renditjes e kandidatëve, sipas rezultateve të provimit, dhe publikon listën e miratuar, deri në datën 15 maj të çdo viti, duke treguar në listë numrin maksimal të kandidatëve të pranuar në formimin fillestar, në përputhje me vendimin e Këshillave, të marra sipas përcaktimeve të nenit 29 të këtij ligji”.

Ndërsa në pikën 5, të nenit 262, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Viti akademik hapet të hënën e parë të muajit tetor dhe mbaron jo më vonë se fundi i korrikut të vitit pasardhës”.

Ndërkohë, në Kreut IX, Seksioni A, pika 4, të Vendimit të Këshillit nr.75/2019, përcaktohet se: “Jo më vonë se 21 ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularit të deklarimit të pasurisë, kandidati e dorëzon atë të plotësuar pranë ILDKPKI-së. Deklarimi bëhet sipas përcaktimeve të neneve 3/1, 4, pika 2 e vijues të Ligjit nr.9049/2003”.

Në kushtet që gjendemi, ku për shkak të përhapjes së Covid-19 dhe shpalljes së situatës së fatkeqësisë natyrore, organizimi i provimit të pranimit në formimin fillestar nga Shkolla e Magjistraturës, nga fundi i muajit prill (sipas nenit 30 të Ligjit për Statusin) u shty në fund të muajit qershor, çka ka kufizuar kohën në dispozicion të Këshillit për verifikimin e kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, me qëllim për të mundësuar fillimin e vitit akademik në kohën e parashikuar nga ligji, pra të hënën e parë të muajit tetor, pra për një interes të lart publik, ndërkohë që verifikimi me prioritet i kandidatëve të kësaj kategorie është dhe një nga rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, është e domosdoshme marrja e masave për përshpejtimin e procedurave të verifikimit të kandidatëve, ndër to, duke reduktuar, në një masë të justifikueshme dhe të arsyeshme, edhe afatet që Këshilli ka përcaktuar në Vendimin nr. 75/2019. Një nga këto afate, që përfshin një kohë të konsiderueshme në raport me kohën në dispozicion të Këshillit për përfundimin e verifikimit të kandidatëve, është ai për dorëzimin nga ata të formularit të deklarimit të pasurisë pranë ILDKPKI-së. Sipas Vendimit 75/2019, ky afat përcaktohet “jo më vonë se 21 ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularit të deklarimit të pasurisë”, ndërkohë që sipas projektvendimit propozohet që ky afat të caktohet “dy javë, deri në një datë që do ta caktojmë sot”, duke konsideruar në këtë rast kryerjen e të gjitha njoftimeve të para për kandidatët, përfshirë edhe dërgimin atyre, në rrugë elektronike, të formularit të deklarimit të pasurisë, në të njëjtën ditë me atë të miratimit të projektvendimit.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga tre pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit për secilin nga 40 kandidatët për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për të cilët fillon procedura e verifikimit sipas pikës 1 të projektvendimit.

Ndërsa në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se afati i dorëzimit nga kandidatët të formularit “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” është dy javë, deri më datë (që duhet ta përcaktojmë), pikërisht data në përfundim të dy javëve nga dita e nesërme e miratimit të projektvendimit, e cila mbetet të përcaktohet në mbledhjen plenare të Këshillit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa i përket numrit të kandidatëve që do duhet t’u caktohet relatorëve, KZHK propozon që unë si Kryetar i Komisionit të mbaj për verifikim 10 kandidatë, ndërsa dy anëtarët e tjerë të Komisionit, zonja Shehu dhe zoti Toro të mbajnë për verifikim 15 kandidatë.

Sa i përket procedurave të shortit, ai të bëhet në të njëjtën mënyrë siç kemi proceduar edhe më parë. Në një enë të hidhen emrat e tre relatorëve, ndërsa në enën tjetër të hidhen emrat e 40 kandidatëve. Të përzgjidhet relatori i parë, dhe në varësi do të zgjidhen 10 apo 15 emrat e kandidatëve që do duhet bëjnë verifikimin. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, të vijojmë me hedhjen e shortit.

Jemi dakord me propozimin e bërë nga zoti Toska për shpërndarjen e numrit të kandidatëve ndërmjet anëtarëve të Komisionit?

A jemi dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Në vazon e madhe do hidhen emrat e kandidatëve për magjistratë.

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e 40 kandidatëve për magjistratë: {...} – {...}.

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e anëtarëve: z. Ilir Toska, znj. Marçela Shehu, z. Alban Toro.

Relatori i parë i përzgjedhur është z. Ilir Toska, për të cilin do të përzgjidhen 10 kandidatë: {...} – {...}.

Relatori i dytë i përzgjedhur është z. Alban Toro, për të cilin do të përzgjidhen 15 kandidatë: {...} – {...}.

Relatori i fundit mbetet znj. Marçela Shehu, për të cilën do të përzgjidhen 15 kandidatë: {...} – {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, hedhim në votim projekt-aktin, së bashku me shortin e kryer.

Maksim Qoku: Dakord.

Ilir Toska: Më falni! Duhet të fiksojmë, tek pika 3, datën, që i bie të jetë data 4 gusht. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
2. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
3. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;
4. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;

5. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
6. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
7. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;
8. Për kandidatin z. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
9. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
10. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
11. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
12. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
13. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
14. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
15. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
16. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
17. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
18. Për kandidatin z. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
19. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;
20. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
21. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;
22. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
23. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
24. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
25. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
26. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
27. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;
28. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
29. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;
30. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
31. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
32. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;
33. Për kandidatin z. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
34. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;

35. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;
36. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;
37. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu;
38. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
39. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
40. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu.

3. Afati i dorëzimit nga kandidatët të formularit “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” është dy javë, deri më datë 04.08.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq mbyllim mbledhjen për sot.

Ditë të mbarë.

* * *

(Mbledhja konsiderohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor